

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit - Fizikë (Master)
Titulli i lëndës:	Mësimdhënia dhe të nxënit e fizikës II.
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Laboratori i Fizikës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Zeqir Shaqiri
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:zekiinst@yahoo.com">zekiinst@yahoo.com</a> , <a href="mailto:zeqir.shaqiri@uni-pr.edu">zeqir.shaqiri@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kursi fokusohet në përpjekjet për të gjetur dhe aplikuar mënyrat më efikase për të arritur qëllimet e përgjithshme dhe ato specifike të mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e fizikës duke u bazuar në specifikat e dukurive natyrore dhe dokumenteve kurrikulare në Kosovë.</p> <p>Temat e zgjedhura nga ky kurs kanë të bëjnë me një theks të veçantë në integrimin e leksioneve, eksperimenteve, teknologjisë informative, verifikimin dhe vlerësimin e njohurive të elektricitetit, elektromagnetizmit dhe optikës. Vëmendje të posaçme do t'i kushtohet demonstrimit, të vërejturit dhe eksperimentit në mësimdhënien e fizikës duke i ilustruar me shembuj konkret. Në fushën e demonstrimit do të marrim shumë shembuj nga jeta e përditshme.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi është që të zhvillohet mundësia e të kuptuarit dhe të menduarit shkencor të dukurive natyrore; prezantimi, interpretimi dhe demonstrimi i dukurive fizike, të zotërojnë metodat kryesore të matjeve dhe ato t'i zbatojnë në ushtrimet laboratorike të nxënësve, të paraqesin dhe të interpretojnë të dhënat eksperimentale dhe ato t'i ndërlidhin me të dhënat teorike, të vlerësojnë saktësinë dhe jo saktësinë e të dhënave nga eksperimenti.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Në përfundim të lëndës studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• fitojë njohuri dhe shkathtësi që të organizojë, zbatojë dhe interpretojë demonstrimin në mënyrë të natyrshme thjeshtë, shpejtë, konkretisht,</li> <li>• të njihen me metodat e interpretimit, demonstrimit dhe eksperimenteve laboratorike të zbatuara në klasë,</li> <li>• zgjedhë mjetet dhe metodat e përshtatshme për</li> </ul>

	<p>demonstrime dhe ushtrime eksperimentale,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezantojë, analizojë dhe interpretojë të dhënat e marruara gjatë demonstrimeve dhe eksperimentit, të bëjë lidhjen e tyre me teorinë dhe vlerësimin e saktësisë së matjeve duke përdorë edhe kompjuterin në punën eksperimentale,</li> <li>• të jetë kreativ dhe të zhvillojë aftësi për të kuptuar dhe interpretuar në mënyrë shkencore dukuritë fizike, fitojë aftësi për të eksperimentuar në mënyrë të sigurt, aftësi për vlerësimin e rrezikut gjatë punës dhe njohjen e rregullave të sigurisë.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume, seminare	1	15	15
Detyra të shtëpisë	/	/	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	/	/	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	/	/	6
Projektet, prezantimet , etj	/	/	4
<b>Totali</b>			<b>140 Orë</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjerata interaktive, puna në grupe, punë individuale, punë në çifte, punë seminarike / projekte, demonstrimi i dukurive të ndryshme fizike, eksperimente, punë praktike individuale për përgatitjen dhe demonstrimin e eksperimenteve të ndryshme. Në laborator duke nxitur kreativitetin e tyre se si të ndërtojnë demonstrime.		
<b>Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:</b>	Projekt i përbashkët, prezantim i studentëve, test afatmesëm dhe test final;		
<b>Mjetet e konkretizimit:</b>	Laptop, Bimprojektor, Letër flipcart, demonstrimi, eksperimenti.		

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. USAID (2009): <i>Mësimi i Fizikës në shekullin 21</i>, Shkup.</li> <li>2. Shaqiri, Z (2017): <i>Praktikumi i ushtrimeve eksperimentale</i>, Prishtinë.</li> <li>3. Xh. Ibrahim. <i>Fizika 2</i> , SHLP.</li> <li>4. F. Gashi (1983). <i>Fizika 2</i>, FSHMN., Prishtinë</li> <li>5. G. Ruffo (2006): <i>Fizika kl. 11</i>, Uegen. Itali.</li> <li>6. B. Shkurtaç, M. Shenaj (2011). <i>Fizika e Përgjithshme: Elektriciteti dhe Magnetizmi</i> Shblu. Tiranë.</li> <li>7. F. Sinojmeri, Zenun Mulaj (1998). <i>Fizika 2 (Elektromagnetizmi)</i>.Shblu. Tiranë.</li> <li>8. D. Holliday, R. Resnic (2001). <i>Fundamentals of physics</i>. USA.</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Musai, B, ( 2008) <i>Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues</i>, Fizikë 6-12, CDE .</li> <li>• Arar, Lj., Kolić-Vehovec, S., Milotić, B.,( 2009) “<i>Kako lakše učiti fiziku</i>”, Školska knjiga, Zagreb.</li> <li>• Krsnik, R.,( 2008) “<i>Suvremene ideje u metodici nastave fizike</i>”, školska knjiga, Zagreb.</li> <li>• Galaxy, Geri (2014): <i>Eksperimente fizike (shqip)</i>, Tiranë.</li> <li>• Loyd, David (2013): “<i>Physics Laboratory Manual Paperback</i>” Edition: 4<sup>th</sup></li> <li>• Halliday, Resnick &amp; Walker (2011): <i>Fundamentals of Physics</i>, 9<sup>th</sup> Edition, John Willey &amp; Sons, , USA.</li> <li>• Floran Vila, Rexhep Mejdani (2005): <i>Elektromagnetizmi</i>, shblu,Tiranë.</li> <li>• I, Xhevdet (2003): <i>Metodika dhe teknika e eksperimentit demonstrues</i>, Prishtinë.</li> </ul>
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Paraqitja e kursit, Syllabusi dhe detyrat
<b>Java e dytë:</b>	Mësimi i fizikes i bazuar në kompetenca (fusha e kurikules)
<b>Java e tretë:</b>	Planifikimi i mësimdhënies për shkollën e mesme të ulët dhe të lartë
<b>Java e katërt:</b>	Roli i mësimdhënësve të fizikës dhe marrëdhëniet

	profesionale (formulimi i detyrave për dy nivele)
<b>Java e pestë:</b>	Mësimdhënia e bazuar në elektrostatiqe (ushtrime, demonstrime, ushtrime interaktive)
<b>Java e gjashtë:</b>	Modelet e mësimdhënies në fushën e fenomeneve magnetike dhe elektrike
<b>Java e shtatë:</b>	Testi 1
<b>Java e tetë:</b>	Mësimdhënia e bazuar në lëkundjet, valët elektromagnetike dhe optikën valore
<b>Java e nëntë:</b>	Të menduarit e nxënësve për gjeometrin e dritës dhe instrumentet optike
<b>Java e dhjetë:</b>	Zhvillimi i të menduarit të nxënësve për reflektimin, thyerjen, disperzionin, interferencën dhe difraksionin.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Metodologjia e zgjedhjes së detyrave numerike në fushën e elektrostatiqes, elektromagnetizmit dhe optikës.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Zhvillimi i mësimdhënies dhe të nxënësve të lëndës së fizikës nëpërmjet hulumtimit, laboratorit virtual, eksperimental dhe demonstrues.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Testi 2
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Prezantimi i projekteve
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Prezantimi i projekteve

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	
Pjesa teorike	Pjesa praktike
60%	40%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve</li> <li>- Bashkëpunim i bazuar në rregullat universitare</li> <li>- Respektimi i orarit të mësimin dhe konsultimeve</li> <li>- Respektimi të specifikave laboratorike dhe atyre mësimore</li> <li>- Respektim i kodit dhe Statutit të Universitetit</li> </ul>